

Data: 03.08.2018

Ref.: 8711180

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.9/2017, datë 02.08.2017), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 58-të, të mbajtur më 23 korrik 2018, mori:

### V E N D I M

1. Tërhiqet akreditimi i programit të studimit të BPrAL Kolegji "AAB", kampusi në Prishtinë:
  - Politikat Sociale dhe Mirëqenja e Fëmijëve, MA, 120 ECTS.
2. Tërhiqet akreditimi i programeve të studimit të Kolegjit "AAB", dega në Gjakovë:
  - Menaxhment dhe Informatike, BSc, 180 ECTS, dhe
  - Administratë Publike, BA, 180 ECTS, Dega Gjakovë.
3. Tërhiqet akreditimi i programit të studimit të Kolegjit "AAB", dega në Ferizaj:
  - Marketing dhe Administrim Biznesi, BA, 180 ECTS.
4. Hiqet masa e pezullimit për programin e studimit:
  - Juridik Penal, LLM, 60 ECTS.
5. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

### Arsyetimi

Bazuar në Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (tash e tutje UA për Akreditim), neni 21 dhe 26, pika 5.3.4, Agjencisë së Kosovës për Akreditim (tash e tutje AKA) me datë 23 maj 2018 ka kërkuar nga të gjitha Institucionet e Arsimit të Lartë (tash e tutje IAL) që ti dorëzojnë listat e stafit akademik për secilin program të studimit. Në afatin e përcaktuar nga AKA, Kolegji "AAB" ka dorëzuar listat për programet e studimit.

Bazuar ne te dhënat e prezantuara nga ky IAL, për programet e studimit: Politikat Sociale dhe Mirëqenja e Fëmijëve, MA, 120 ECTS, kampusi në Prishtinë, Menaxhment dhe Informatike, BSc, 180 ECTS, dega në

Gjakovë, Administratë Publike, BA, 180 ECTS, dega në Gjakovë; Marketing dhe Administrim Biznesi, BA, 180 ECTS, dega në Ferizaj, (sipas kërkesës së AKA-së datë 23.05.2018) konfirmohet se për këto katër programe të studimit nuk kanë asnjë staf akademik si bartës të programeve të cekura me lartë.

Për programet e studimit Menaxhment dhe Informatike, BSc, 180 ECTS, Administratë Publike, BA, 180 ECTS, Dega Gjakovë, dhe Marketing dhe Administrim Biznesi, BA, 180 ECTS, Dega Ferizaj, në bazë të dokumenteve të dorëzuara nga ky institucion, u konstatua që nuk ka staf akademik sipas kërkesave që dalin nga neni 26, pika, 5.3.9. e UA për Akreditim. Sipas kësaj dispozite: "Kriteret e lartpërmendura për stafin akademik apo titujt e barasvlershëm artistik do të kërkohen edhe për secilin program studimi që ofrohet në degë apo kampuse tjera, përpos kampusit kryesor". Kjo dispozitë i referohet nenit 26, pika 5.3.4.

Sipas nenit 26, pika 5.3.4 kërkohet që: "Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë që për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statutit të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit të studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD apo titull të barasvlershëm artistik nga fusha e programit të studimeve". Pra siç mund të shihet nga sa u tha me sipër, kërkohet që për çdo 60 ECTS, IAL duhet të ketë një person në marrëdhënie të rregullt të punës me gradën shkencore PhD dhe të jetë i fushës së programit të studimit.


Për programin e studimit Juridik Penal, LLM, 60 ECTS, kampusi në Prishtinë, Kolegji "AAB", si bartës të këtij programi ka vendosur Prof Ass Dr.sc Veton Vula. Pas vlerësimit të dosjes së stafit, u konstatua që bartësi i programit është i fushës së studimit, dhe ka dokumentacion të rregullt, dhe me këtë raste KSHC vendosi të aprovoj kërkesën e Kolegjit AAB për heqjen e masës së pezullimit.

Sipas nenit 21, pika 1 e UA për Akreditim (9/2017), thuhet se: "AKA e rezervon të drejtën të monitoroj dhe të kontrollojë cilësinë e institucioneve të akredituara në çfarëdo kohe me paralajmërim". Ndërsa sipas pikës 2 të nenit 26 të UA për Akreditim thuhet: "AKA mund të rishqyrtojë akreditimin e dhënë në çfarëdo kohe dhe/ apo më pas të tërheq vendimin e saj për akreditim nëse kushtet e dhëna me rastin e akreditimit janë shkelur". Bazuar në këtë çka u tha me sipër dhe në mungesë të stafit akademik për programet e cekura në pikat 1,2 dhe 3 të këtij vendimi, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (tash e tutje LPPA) nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenit 128 të LPPA, në afatin prej 30 nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolegji AAB;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



---

Prof. Dr. Gazmend Luboteni  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

